



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH .nr. 532/19**  
**533 /19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z .Nuhi Paçarizi- Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Bajraktari”sh.p.k -Vushtrri, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit të lumit SITNICA & IBER në Mitrovicë, bashkëfinancim me MMPH” me nr. të prokurimit: 642-19-6016-5-1-1 & 642-19-6016-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/–Komuna e Mitrovicës, më datën: 12.09.2019, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Bajraktari”sh.p.k -Vushtrri, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit të lumit SITNICA & IBER në Mitrovicë, bashkëfinancim me MMPH” me nr. të prokurimit: 642-19-6016-5-1-1 & 642-19-6016-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/–Komuna e Mitrovicës.

**II. I LEJOHET**, autoriteti kontraktues -Komuna e Mitrovicës, që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit, dhe të veproj konform nenit 53.7 të LPP-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit të lumit SITNICA & IBER në Mitrovicë, bashkëfinancim me MMPH” me nr. të prokurimit: 642-19-6016-5-1-1 & 642-19-6016-5-1-1, përkitazi me këtë ankesë ( nëse nuk ka ankesë tjetër).

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues OE “Bajraktari” sh.p.k -Vushtrri, aprovohet pjesërisht si e bazuar, të njëjtit i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt:13.08.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 27.08.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 27.08.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 19.08.2019.

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt:21.08.2019.

Operatori ekonomik ankues OE “Bajraktari”sh.p.k -Vushtrri, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 22.08.2019 me nr. 532 dhe 533/ 19, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit të lumit SITNICA & IBER në Mitrovicë, bashkëfinancim me MMPH” me nr. të prokurimit: 642-19-6016-5-1-1 & 642-19-6016-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/–Komuna Mitrovicë, duke pretenduar se :

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 21, 27, dhe 69, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 18.9, 26.4, dhe 44.9 të RRUOPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 27.08.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.



Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 05.09.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**Sqarim Hyres:**

Autoriteti Kontraktues/ Komuna Mitrovicë për këto aktivitete të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, llojet e kontratave janë punë, kontrata publike (kornizë 24 muaj) me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore të parashtruesit të ankesës përsëri kanë të bëjnë kundër njoftimeve për kontratë, përkatësisht kundër kërkesave të kualifikimit të aplikuara përmes dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, kundrejt të dy procedurave të prokurimit, si për lumin Sitnica, ashtu edhe për lumin Iber.

Kundër njoftimeve për kontrata në afatin e paraparë me LPP, janë paraqitur kërkesa për ri shqyrtim, me pretendimet e njëjta ankimore si në OSHP. AK/ Komuna Mitrovicë, përmes përgjigjeve përsëri ka refuzuar kërkesat si të pa baza

Fillimisht po sqarojmë se për këto aktivitete të prokurimit, OSHP, përkatësisht paneli shqyrtues më datën 09.08.2019, ka nxjerr vendime të veçanta, ato me nr. 326/19, dhe 333/19, (palët janë të njëjta dhe aktiviteti i njëjtë) ku disa nga pretendimet ankimore tanimë janë trajtuar dhe gjykuar. Për të dy procedurat e prokurimit paneli shqyrtues e ka obliguar AK/ Komuna Mitrovicë, që ti bëjë ndryshimet e nevojshme sipas nenit 53.7. AK, nuk e ka përfill te njëjtin obligim, rrjedhimisht ka ngarkuar dosje të reja për të dy aktivitetet e prokurimit, përkatësisht njoftimet për kontrata janë ngarkuar më datën. 13.08.2019.

Meqë jemi autorizuar dhe kemi pranuar autorizimin për trajtim të përbashkët të dy procedurave të prokurimit, përkatësisht pretendimet ankimore janë të njëjta si për lumin Sitnica, ashtu edhe për Lumin Iber, përmes këtij raporti po i trajtojmë ankesat si të përbashkëta.

Përgjigje në pretendimet ankimore (neni 113)

Pala përmes ankesave, përsëri konteston kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, në pozicionet: 2, “menaxheri i projektit” & “udhëheqësi i punishtes”, përkatësisht, kërkesën për 10 vite përvojë pune pas diplomimit, kontrata valide me operatorin ekonomik, si dhe listën e pagave për 6 muajt e fundit. Edhe për pozicionet. 5, 6, 7, 8 dhe 9, të pikës 9.1 & 9.2, të FDT-se, kontestohet kërkesa për përfshirje në listën e pagave në 6 muajt. Përmes raportit paraprak (për lumin Iber) i kemi trajtuar të njëjtat pretendime, megjithatë tani po sqarojmë në mënyrë edhe më të zgjeruar.

Sipas rregullave ligjore në fuqi për prokurimin publik në Kosovë, është e ndaluar përgatitja e dosjes së tenderit në një mënyrë që favorizon ose diskriminon kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik



potencial, rrjedhimisht, kërkesat e AK-së, kundrejt stafit të operatoreve ekonomik potencial, që të paraqesin listë të pagave kundrejt stafit të tyre po ashtu edhe kontratë valide me operatorin ekonomik, bien ndesh me kërkesat e nenit 69, par 6, të LPP-së. Kërkesat e njëjta ndërlidhën me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, rrjedhimisht përcaktojnë ose sqarojnë se për procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike, në të cilën përfshihet realizimi i projekteve të punëve AK-të mund të kërkojnë informata për kualifikimet shkollore të personelit përgjegjës për realizimin e projektit. Pra aplikimi i kërkesës, përkatësisht paraqitja e listës së pagave dhe përvoja e punës (10 vite pas diplomimit) si dhe kontrata valide me operatorin ekonomik, nuk parashihen të aplikohen dhe kërkesat si të tilla bien ndesh edhe me dispozitat tjera të LPP-së, siç është paragrafi 2, i nenit 7, të LPP-së, ku shprehimisht potencon: “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik”.

Edhe kërkesa për pasjet teknike përkatësisht kapacitetin e kamionëve (15-20 m<sup>3</sup>), me kufizim të tillë (prag dhe tavan) bien ndesh me rregullat ligjore dhe nën ligjore të prokurimit publik në fuqi. Po ti referohemi vetëm titujve të aktivitetit të prokurimit, tregohet se punët do të realizohen në ambient të hapur dhe kufizimi i makinerisë për aktivitete të tilla është diskriminues apo edhe favorizues. Është e mjaftueshme të përcaktohet vetëm pragu i kapacitetit, rrjedhimisht vlerësimi ynë është se kërkesat e tilla nuk e bëjnë një operator ekonomik me të kualifikuar apo të profesion analizuar për realizimin e drejte dhe korrekt të projektit përkatës.

Përfundimisht në mbështetje të asaj që u përshkrua me lartë përkatësisht në mbështetje të pretendimeve ankimore, propozimi ynë për AK – Komuna Mitrovicë është që ti anulohet procedurat e prokurimit, si për lumin Ibër po ashtu edhe për lumin Sitnica, dhe në rast të ri tenderimit, paraprakisht ti referohet dispozitave të LPP-së, në përgjithësi dhe në veçanti:

Ti referohet nenit 27, të LPP-s dhe të hartohet dosjes objektive në mënyrë që nuk kufizon konkurrencën;

- Ti referohet nenit 21 të RRUOPP-së, dhe të respektohen afatet minimale për ofertim.
- Ti referohet edhe nenit 44, të RRUOPP-së, dhe të ndiqet procedurat e anulimit dhe ri tenderimit dhe të përshkruhet termi “Ri tender” (shiko, par 11, neni 44).

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues “Bajraktari” shpk, të aprovohet si e bazuar, (si për lumin Sitnica, ashtu edhe



për lumin Iber), ndërsa aktivitetet e prokurimit të anulohen dhe nëse AK, ka ende interes të njëjtat, të RI TENDEROJ.

Operatori ekonomik "Bajraktari" sh.p.k -Vushtrri, përmes parashtresës me shkrim të datës: 05.09.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Mitrovicës, përmes parashtresës me shkrim të datës: 06.09.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12.09.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i AK-së, përfaqësuesi i OE-së ankues, ndërsa eksperti shqyrtues nuk ka qenë prezent në seancë, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së, z. Fetoshi deklaroi: Në qëndrojmë në tërësi prapa pretendimeve tona ankimore dhe konsiderojmë se DT nuk është bërë në harmoni me nenin 27 të LPP-së sepse janë kërkuar kërkesa dhe dëshmi favorizuese dhe diskriminuese në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues tek kapacitetit teknik dhe profesional ka kërkuar ndër të tjera edhe listën e pagave të punëtorëve ndërsa si kërkesë dhe dëshmi është kërkuar që punëtorët të jenë në 6 muajt e fundit në listën e pagave të OE. Në mendojmë që kjo kërkesë nuk duhet të ekzistoj sepse rëndësishme është që të kërkohen dëshmi tjera si përvoja e stafit, inxhinierive dhe të ekzistojnë eventualisht kontratat edhe për këtë projekt të nënshkruara me staf profesional dhe njëkohësisht të ju krijohet hapësirë për ofertim edhe OE-ve, të tjerë të cilët nuk mund të kenë të gjitha këto dëshmi dhe të mbulojnë vetëm. Ky pretendim i yni vlen për të dy AP dhe gjithashtu i njëjti pretendim vlen edhe për kërkesat me nr. rendor 5,6,7, dhe 9. Si pretendim tjetër kemi edhe në lidhje me një kërkesë për kamionin me kapacitet 15-20 m<sup>3</sup> ku mendojmë se kjo kërkesë është shumë e ngushtuar dhe kufizuese dhe mendojmë se duhet të caktohet vetëm një minimum i kësaj kërkesë.

Si pretendim tjetër e kemi edhe afatin kohor për zhvillimin e kësaj procedure e cila është e publikuar me afate të përshpejtuar por konsiderojmë që në këtë rast është vepruar në kundërshtim me nenin 21 të RRUOPP-së, sepse shkurtimi i afateve kohore për procedurat për vlerat e mëdha nuk mund të jete më pak se 15 ditë ndërsa Autoriteti Kontraktues e ka parapare afatin 11 ditë.



Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Ferati deklaroj: Ne pretendimit të OE-së, sa i përket afateve ne pretendojmë se OE ka bërë vërejtje të pa bazë për arsye se ne si Autoriteti Kontraktues e kemi vazhduar afatin ne kërkesën e OE dhe kemi bërë njoftimin ne e-platformën elektronike për informata shtese dhe përmirësim gabimesh.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE se lënda duhet të shkoj ne Ri-tender këta e dime mire se Lënda është ne Apel dhe pasi që të merret vendimi nga Paneli ne menjëherë bëjmë njoftim për informata shtese dhe e vazhdojmë afatin.

Sa i përket pretendimit , te OE sa stafit ne kemi kërkuar që inxhinieret të kenë përvojë 10 vjeçare qe është shume normale sepse jemi 20 vjet pas përfundimit të luftës dhe ka Inxhinier me nr te pa kufizua me përvojë 10 vjeçare, sa i përket stafit ne kemi kërkuar qe stafi të jete ne listën e pagave arsyeja se është projekt milionësh dhe OE-të kanë mundësi të bëjnë konsorciume dhe te kenë punëtor ne listën e pagave e jo si një shembull ne KK-Mitrovice ku OE nënshkruan kontrata me punëtor të rrugëve dhe me punëtor të restoranteve për kryerje të punëve të ndërtimit.

Dhe pretendimi tjetër sa i përket pajisjeve ne kemi kërkuar qe kamionët te jene me kapacitet 15-20 m3 unë e as Autoriteti Kontraktues nuk e di ku mundet të ceket se këtu është kriter diskriminues dihet se për këto projekte me fol shkurt” me kolica nuk punohet”.

Një vërejtje qe ka dhënë OE se ne DT nuk është cekur Ri-tender unë e kam njoftimin për kontrate qe e ka publikuar KRPP dhe shkruan RITENDER.

Autoriteti Kontraktues KK-Mitrovice plotësisht ka zbatuar vendimin panelit me nr 326/19 për kriteret e aprovuara dhe ne tërësi i ka publikuar ndryshimet te cilat i ka aprovuar paneli i OSHP-së.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Fetoshi deklaroj: Kërkojmë na paneli shqyrtues që të aprovoj ankesën tone si të bazuar dhe që ky AP të kthehet qe nga fillimi ne (Ri tenderim) dhe te parashihen afatet normale kohore sepse OE-ve ju duhet kohe me e gjatë për tu përgatitur për këta tender që kanë vlera të mëdha dhe njëkohësisht të ndryshohen kërkesat e DT-së, qe i kemi te cekura ne ankese.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Ferati deklaroj: Kërkoj nga paneli shqyrtues qe kërkesa e Autoriteti Kontraktues te aprovohet ne tërësi dhe te vazhdohet me procedurën e prokurimit e cila është ne platformën elektronike e cila është ne Apel dhe procedura të mëtejshme.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në



procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se paneli shqyrtues ka nxjerr dy vendime lidhur me këtë aktivitet të prokurimit PSH nr. 326/19, dhe PSH.nr. 333/19, ku palët janë të njëjta dhe aktiviteti i njëjtë, ku ka obliguar autoritetin kontraktues Komuna Mitrovicë, që ti bëjë ndryshimet e nevojshme sipas nenit 53.7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion sqaron se autoriteti kontraktues Komuna Mitrovicë, ka përfillur vendimet e lartpërmendura duke larguar kriteret diskriminuese nga dosja e tenderit.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues se autoriteti kontraktues Komuna e Mitrovicës, ka caktuar kriter listën e pagave të punëtorëve, 10 vite përvojë për inxhinieret dhe kontratat e punës me operatorët ekonomik.

Paneli Shqyrtues, pas dëgjimit të palëve në seance të datës: 12.09.2019, vlerëson se arsyetimi i autoritetit kontraktues qëndron, sepse kjo kontratë është vlerë e madhe dhe operatorët ekonomik kanë mundësi që të hyjnë si konsorcium me qëllim që të plotësojnë kriteret e kërkuara pra që ta plotësojnë njëri tjetrin në kërkesat e AK-së. Për më tepër, Paneli Shqyrtues duke marrë për bazë ekonomikitetin dhe efikasitetin sipas nenit 6 të LPP-së, vlerëson se në një aktivitet të prokurimit, veçanërisht kur kontrata është vlerë e madhe, Paneli Shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues është i obliguar që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit. Pra kërkesa e autoritetit kontraktues për përvojën e punës së inxhinierit prej 10 vite, kontratat e punës me OE, si dhe listën e pagave për gjashtë muajt e fundit, Paneli Shqyrtues vlerëson se janë kërkesa legjitime për tu siguruar që operatorët ekonomik i përmbushin detyrimet me përpikëri sipas kushteve të kontratës.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues lidhur me paisjet teknike përkatësisht kapacitetin e kamionëve (15-20 m<sup>3</sup>), Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues Komuna e Mitrovicës, e ka lejuar mundësin që operatorët ekonomik mund të kenë kamione me kapacitet prej 15-20 m<sup>3</sup>. Pra, nuk është kërkesë për një kamion me kapacitet fikse por AK ka caktuar minimumin dhe maksimumin.

Paneli shqyrtues sqaron se sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues lidhur afatin e shkurtuar pasi që AK në vend të 15 ditëve afatin për dorëzim e ka parapare 11 dite, qëndron ky pretendim si i bazuar. Dhe pas marrjes së këtij vendimi, Autoriteti kontraktues duhet që ta bëjë zgjatjen e afatit kohor për zhvillimin

e kësaj procedure konform nenin 53.7 të LPP-së, në të cilin thuhet: *Nëse, në një aktivitet të prokurimit që përfshin përdorimin e procedurave të hapura, të kufizuara ose të negociuara, autoriteti kontraktues u jep informata sqaruese ose plotësuese operatorëve ekonomik, dhe afati në të cilin informatat e tilla jepen është më i shkurtër se dhjetë (10) ditë nga afati i caktuar për pranimin e tenderëve, autoritetit kontraktues do t'i zgjatet afati i tillë për t'i dhënë operatorëve ekonomik së paku dhjetë (10) ditë nga dita në të cilën informatat përkatëse jepen për t'i dorëzuar tenderët e tyre. Nëse një operator ekonomik ka dorëzuar një tender, operatorit të tillë ekonomik do t'i lejohet që të dorëzojë një përmirësim për tenderin përkatës, por përmirësimi i tillë kufizohet vetëm në ndryshimet që janë të lidhura me informatat e tilla të arsyeshme sqaruese ose shtesë.*

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Blerim Dina

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK- KK-Mitrovicë
- 1x1 OE- "Bajraktari"SH.P.K.Vushtrri
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.